



Njësia e personelit / Kadrovska Jedinica/Personnel Unit

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLICA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5536 Nr. i faq./Br.str./No.pg 56
Data/Datum/Date 4 / 4 / 25
RAHOVEC / ORAOVAC

Për/Za/To: Z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit

Nga/Od/From: Agron Thaqi, Menaxher i Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit

Lënda /Svrha/Subjekt/: Raporti Tre Mujor i Punës i Njesisë së Personelit, për periudhën janar-mars 2025

I nderuar Kryetar,

Në vijim, po ju paraqes raportin tre mujor të punës së Njesisë së Personelit së Komunës për periudhën janar-mars 2025. Ky raport ofron një pasqyrë të detajuar mbi aktivitetet dhe arritjet e Njesisë së Personelit, duke përfshirë proceset e rekrutimit, administrimin e burimeve njerëzore dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe institucionale.

1. REKRUTIMET – Pranim

Gjatë periudhës së përmendur, janë shpallur gjithsej 25 konkurse publike, prej të cilave 12 në shërbimin civil, 10 në Drejtorinë për Arsimit dhe 3 në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale. Të gjitha procedurat e Shërbimit Civil janë realizuar përmes programeve elektronike, një praktikë unike për Republikën e Kosovës. Gjithashtu, konkursat për sektorët e Arsimit dhe Shëndetësisë janë shpallur në platformën elektronike hrms.rks-gov.net.

2. PUSHIMET VJETORE

Përgjatë kësaj periudhe, punëtorët kanë shfrytëzuar ditët e mbetura të pjesës së dytë të pushimit vjetor për vitin 2024.

3. LËSHIMI I AKTEVE ADMINISTRATIVE

Njësia e Personelit ka hartuar 60 shkresa administrative gjatë periudhës janar-mars 2025, duke përfshirë kontrata, vërtetime, vendime, draft-vendime, propozime, aktemërime, informata, njoftime, kërkesa, raporte dhe shkresa të tjera. Po ashtu, janë dërguar mbi 80 email-e zyrtare.

4. TABELAT STATISTIKORE

Të dhënat statistikore të personelit janë proceduar drejtpërdrejt në programin elektronik HRMIS, në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (MPB/DMZP). Njësia e Personelit ka siguruar të dhëna statistikore për sektorët e Arsimit dhe Shëndetësisë nga zyrtarët përkatës.

5. VLERËSIMI I PUNËS PROVUESE

Në këtë periudhë, janë kryer 4 vlerësime të punës provuese për punëtorët që kanë kaluar gjashtë muaj pune në komunë.

6. VIJUESHMËRIA E PUNËTORËVE NË PUNË

Sistemi i mbikëqyrjes së vijueshmërisë së punëtorëve është funksional dhe përdoret rregullisht për të monitoruar praninë e punëtorëve. Çdo muaj, Njësia e Personelit dërgon raporte për vijueshmërinë e punës te Kryetari i Komunës, i cili është përgjegjës për verifikimin e mungesave.

7. NDËRPRERJA E MARRËDHËNIES SË PUNËS

Gjatë periudhës janar-mars 2025, tre punëtorë janë pensionuar.

8. PLANI I TRAJNIMEVE TË NËPUNËSVE CIVILË

Menaxheri i Burimeve Njerëzore ka përgatitur planin e trajnimeve për vitin 2025 dhe e ka dërguar për aprovim në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (DMZP).

9. VENDIMET NGA KPMSHCK-ja

Gjatë periudhës janar-mars 2025, nuk ka pasur asnjë vendim të marrë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës (KPMSHCK).

10. TË DHËNAT NGA KOMISIONET E SHËRBIMIT CIVIL TË ADMINISTRATËS KOMUNALE

I. Komisioni Disiplinor

Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur asnjë rast për ndjekje disiplinore. Njësia e Personelit kryen detyrat e sekretarisë për Komisionin Disiplinor, duke lëshuar shkresat administrative, përveç vendimeve, të cilat janë jashtë kompetencës së Njesisë.

11. MENAXHIMI I BURIMEVE NJËRËZORE SIPAS PROGRAMIT HRMIS

Njësia e Personelit vazhdon të menaxhojë programin elektronik HRMIS, duke e populluar dhe përditësuar atë me të dhëna sipas kërkesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ky program është i dizajnuar për menaxhimin elektronik të burimeve njerëzore dhe përfaqëson një nga prioritetet e reformës në administratën shtetërore të Qeverisë së Kosovës.

12. PLANI I PERSONELIT

Njësia e Personelit ka përgatitur draft-planin e Personelit të Komunës së Rahovecit për vitin 2025, i cili është duke u hartuar në mënyrë elektronike, në përputhje me programin HRMIS dhe pritet të aprovohet nga DMZP. Asnjë punësim në Administratën Komunale nuk mund të realizohet nëse pozitat nuk janë përfshirë në këtë plan.

13. ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE ELEKTRONIKE

Njësia e Personelit menaxhon dhe monitoron disa programe elektronike që lidhen me burimet njerëzore, si në vijim:

- Programi elektronik HRMIS, ku realizohen procedurat e rekrutimit.
- Sistemi i monitorimit të prezencës (SMVP), i cili ndihmon në mbikëqyrjen e vijueshmërisë së punëtorëve.
- Programi SMAED, i cili është administruar pjesërisht nga Njësia e Personelit, me kompetencë të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI).
- Programi SMP, i cili menaxhon listat e pagave dhe pagesat e punëtorëve në komunë.

Përfundim

Ky raport tregon përkushtimin e Njesisë së Personelit në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe sigurinë e standardeve të larta në menaxhimin e burimeve njerëzore. Përmirësimet dhe reformat e vazhdueshme janë në përputhje me prioritetet strategjike të administratës komunale të Komunës së Rahovecit.

Rahovec, 4.4.2025